

Aplikimet për marka tregtare rriten me 12.6 % gjatë vitit 2016



Markat tregtare luajnë një rol të rëndësishëm në ekonominë e tregut. Qëllimi kryesor i mbrojtjes së markës tregtare është stimulimi dhe sigurimi i një konkurrence të ndershme në njërin anë, si dhe mbrojtja e konsumatorit në anën tjetër. Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale ka publikuar së fundmi raportin vjetor për vitin 2016, ku informon publikun mbi arritjet e këtij institucioni në periudhën në fjalë. Përsa i përket markave tregtare, DPPI informon se aplikimet për regjistrim markash në DPPI mund të bëhet nëpërmjet dy mënyrave: 1) Aplikime në rrugë kombëtare nga subjekte shqiptare dhe të huaja dhe 2) Aplikime ndërkombëtare nëpërmjet Marrëveshjes dhe Protokollit të Madridit. Sipas raportit, gjatë vitit 2016, DPPI ka pritur 1055 aplikime për marka, në krahasim me 937 aplikime të vitit 2015, duke shënuar një rritje me 12.6% të aplikimeve për marka. Nga këto aplikime janë ekzaminuar 924 aplikime ose 87.6% e tyre dhe për 350 aplikime janë lëshuar certifikatat e regjistrimit. Gjatë vitit 2016 ka patur rritje numri i aplikimeve kombëtare nga subjekte shqiptare, të cilat arritën në 662 duke u rritur me 30% krahasuar me vitin paraardhës. Numri i aplikimeve nga subjekte shqiptare është pothuajse trefishuar në krahasim me vitin 2010. Markat tregtare kryejnë disa funksione të cilat drejtpërsëdrejti ndikojnë në zhvillimin e ekonomisë së një vendi: funksioni identifikues; funksioni i kontrollit të cilësisë; funksioni i investimit, komunikimit dhe reklamimit; funksioni i të drejtës së pronës private dhe funksioni ekonomik. Përveç funksioneve të lartpërmendura që një markë tregtare mund të ketë, nuk mund të lihet pa u përmendur edhe fakti që e drejta në markën tregtare është e drejtë pronësie.

Gazeta slloake “Pravda” artikull për Shqipërinë: “Destinacion i ri për turistët



Shqipëria, “destinacioni i ri” për turistët sllovakë. Kështu e nis artikullin e saj gazeta e njohur slloake “Pravda”, ku më tej tregohen arsyet pse duhet vizituar Shqipëria, si dhe numri i turistëve që e kanë vizituar vendin tonë përgjatë viteve 2015 dhe 2016. “Shqipëria është ndër destinacionet ku turizmi është zhvillim. Për britanikët, gjermanët, polakët, sllovenët dhe çekët nuk është një vend i panjohur. Rreth 5 milionë turistë të huaj kanë vizituar Shqipërinë në vitin 2015, ku konkretisht rreth 12.000 sllovakëve. Ndërkohë rreth 9 mijë shtetas të tjerë me pasaportë slloake kanë vizituar vendin në vitin 2016, duke pasur rritje në krahasim me vitin 2013”, shkruan gazeta. Sipas “Pravda” të ardhurat nga turizmi në Shqipëri janë 1.5 miliardë euro. “Shqipëria nga turizmi siguron 1.5 miliardë euro të ardhura. Ky vend po e trajton turizmin si një “industri” me rëndësi, ku kjo tregohet edhe me masat që po ndërmerren nga qeveria. Krijimi i vendeve të punës në këtë sektor përbën rëndësi të veçantë, ku në fushën e turizmit janë 7.7 për qind e numrit të përgjithshëm të të punësuarve”. Gazeta shkruan gjithashtu edhe për uljen me 6 për qind të TVSH në sektorin e turizmit: “Shteti ka mbështetur turizmin duke ulur TVSH-në shërbimet e akomodimit nga 20% në 6%”, shkruan gazeta “Pravda”.

<http://nova.blog.pravda.sk/2017/06/18/422/>

Korça e Pogradeci, së shpejti pjesë e tureve ballkanike nga operatorët turistikë



Agjencia Kombëtare e Turizmit, së bashku me Shoqatën Shqiptare të Hotelierisë dhe Shoqatën Ballkanike të Hotelierisë, në kuadër të një bashkëpunimi rajonal midis vendeve të ndryshme të Ballkanit, organizoi me një grup turistësh të ndryshëm nga vende si : Maqedonia , Kosova , Serbia , Kroacia , Bosnje Hercegovina dhe Mali i Zi, një vizitë në qytetin e Pogradecit dhe Muzeun Kombëtar të Artit Mesjetar në Korçë. Turistët u pritën me një banket me ushqime tradicionale të zonës, ku dhe iu prezantua vendi ynë me potencialet e tij turistike, duke u shoqëruar nga spoti zyrtar i “Albania Go Your Own Way” . Mbresa të veçanta, përtej klimës Pogradecare, la sidomos Muzeu i ri i Artit Mesjetar në Korçë, ku vizitorët u mrekulluan nga trashëgimia e pasur kulturore Bizantine e Shqipërisë . Po ashtu, në këtë takim morën pjesë disa gazetarë e media të rajonit dhe operatorë turistikë të cilët, duke parë çfarë ofronin qytete si Pogradeci e Korça, siguruan që kjo zonë e Shqipërisë do bëhet së shpejti pjesë e tureve të tyre në rajon.